



RREGULLAT

PËR PARANDALIMIN, ZBULIMIN DHE HETIMIN E
MASHTRIMIT



I.	Objektivat.....	1
II.	Fushëveprimi dhe zbatimi.....	1
III.	Ndalimi i trajtimit të padrejtë dhe mashtrimit	1
IV.	Kontrollet e menaxhimit të mashtrimit	2
V.	Procedurat dhe aktivitetet e menaxhimit të mashtrimit	3
VI.	Raportimi i mashtrimit të dyshuar	3
VII.	Procedura për trajtimin e raporteve.....	3
VIII.	Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare	4

I. Objektivat

Rregullat për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit (në tekstin e mëtejshëm "Rregullat") i përcaktojnë objektivat, parimet dhe rregullat kryesore për trajtimin e mashtrimeve në Krka, dd, Novo mesto, dhe filialet e saj (në tekstin e mëtejshëm "Krka"). Ato i definojnë edhe detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të Krka-s përkitazi me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit.

Këto Rregulla bazohen në rregulloret dhe rekomandimet në fuqi, dhe në **Kodin e Sjelljes të Krka-s**, në të cilin përcaktohen parimet dhe rregullat për sjelljen etike, praktikën e mira të biznesit dhe standardet e sjelljes në Krka.

Objektivat e Krka-s lidhur me menaxhimin e mashtrimit janë si vijon:

- Ulja e rrezikut nga mashtrimi duke e përdorur parimin e tolerancës zero,
- Ngritja e vetëdijes së punonjësve për mashtrimet e mundshme dhe metodat për menaxhimin e mashtrimit;
- Trajnimi i punonjësve për përgjegjësinë e tyre për zbulimin e rreziqeve nga mashtrimi dhe raportimin e tyre;
- Përmirësimi dhe menaxhimi i vazhdueshëm i sistemeve të kontrollit të brendshëm lidhur me parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit;
- Sigurimi i burimeve të përshtatshme për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit;
- Respektimi i vazhdueshëm i rregulloreve, udhëzimeve dhe kodeve përkatëse;
- Shqetësimi për hetimin në kohë dhe të duhur të mashtrimit të dyshuar;
- Sigurimi i anonimitetit të informatorit;
- Mbrojtja e reputacionit dhe aseteve të Krkës.

II. Fushëveprimi dhe zbatimi

Këto Rregulla zbatohen për të gjithë punonjësit e Krka-s, të cilët duhet të veprojnë në përputhje me to në të gjitha marrëdhëniet e tyre me Krka-n dhe me çdo person tjetër juridik apo fizik (në tekstin e mëtejshëm "palë e tretë").

Çdo punonjës i Krka-s dhe palë e tretë mund ta raportojë çdo mashtrim të dyshuar në përputhje me këto Rregulla.

Këto Rregulla i përcaktojnë parimet dhe rregullat themelore që janë në përputhje me rregulloret në fuqi lidhur me mashtrimin dhe korrupsionin, udhëzimet, standardet ndërkombëtare të sjelljes dhe rregullat e brendshme të Krka-s. Punonjësit duhet t'i marrin gjithmonë parasysh këto gjatë kryerjes së punës së tyre dhe kryerjes së veprimtarisë afariste të Krka-s.

Filialet e Krka-s janë të obliguara që t'u përmbahen dispozitave të këtyre Rregullave duke i marrë parasysh kërkesat e mundshme më të rrepta kombëtare.

Të gjithë punonjësit duhet të njihen me përmbajtjen e këtyre Rregullave, qoftë përmes sistemit të edukimit elektronik të eCampus apo duke e përdorur ndonjë metodë tjetër të përshtatshme. Punonjësit duhet të informohen në mënyrën e duhur për çdo ndryshim në këto Rregulla. Punonjësit e rinj duhet të familjarizohen me përmbajtjen e këtyre Rregullave kur ata i marrin pozitat e tyre të punës.

III. Ndalimi i trajtimit të padrejtë dhe mashtrimit

Ndalohet çdo trajtim i padrejtë dhe mashtrim, siç është përcaktuar në rregulloret në fuqi. Veprime të tilla janë veçanërisht sa vijon:

- **Korrupsioni**, që nënkupton keqpërdorimin e pozitës për të përfituar avantazhe personale apo avantazhe për ndonjë palë të tretë. Veprimi mund të ketë qëllim korruptiv kur premtohet apo jepet me qëllimin për ta nxitur apo shpërblyer ndonjë shkelje të sjelljes së duhur ose kur ndonjë avantazh pranohet si pagesë për sjellje të duhur.

- **Mashtrimi**, që është çdo veprim joetik dhe/ose i paligjshëm që për qëllim ka që të fitohet ndonjë avantazh i paligjshëm apo i padrejtë duke i shkaktuar dëm Krka-s apo palëve të treta. Mashtrimi, për shembull, përfshin lajthitjen, fshehjen apo shkeljen e besimit, apo raportimin financiar mashtrues etj. Mashtrimi kryhet nëse persona apo kompani individuale veprojnë qëllimisht për të përfituar dobi materiale, kryesisht në formën e pronësisë së parave të gatshme dhe asetëve apo për t'i realizuar interesat e tyre në mënyrë të paligjshme, duke e dëmtuar kështu Krka-n apo palët e treta. Personat apo kompanitë mund të përpiqen t'i shmangen shlyerjes së borxheve të tyre apo humbjes së shërbimeve dhe t'i mbrojnë avantazhet e tyre personale apo afariste në mënyrë të paligjshme, duke vepruar në mënyrë mashtruese.
- **Ryshfeti**, që nënkupton pranimin, premtimin, ofrimin, dhënien ose kërkimin e pranimit të ndonjë avantazhi, të menduar si nxitje për veprimtari të paligjshme dhe joetike apo shkelje të besimit.
- **Konflikti i interesit**, që nënkupton një situatë që mundëson apo nxit sjellje që mund të çojë në korrupsion apo akte të tjera të paligjshme. Në një konflikt interesi, një person zakonisht përballet me një zgjedhje midis detyrave dhe kërkesave të pozitës së punës dhe interesave personale të tij.

IV. Kontrollat e menaxhimit të mashtrimit

Aktivitetet e kontrollit për menaxhimin e mashtrimit zbatohen në tërë strukturën organizative të Krka-s. Ato janë përcaktuar për të garantuar cilësi, transparencë, siguri dhe performancë.

Ato bazohen në rregulloret e jashtme dhe të brendshme, standardet, praktikat e mira të biznesit, kodet, sistemet e aprovimit të dokumenteve, fuqizimin dhe llogaridhënien e punonjësve, etj. Aktivitetet e kontrollit synojnë edhe parandalimin e mashtrimit, ngritjen e vetëdijes dhe raportimin e detyrave midis punonjësve dhe zbulimin, vërejtjen dhe hetimin e mashtrimit.

Krka e ka krijuar një mjedis të kontrollit që e mundëson menaxhimin e rreziqeve kryesore strategjike dhe operative, si dhe identifikimin dhe menaxhimin në kohë të faktorëve që mund ta rrezikojnë arritjen e objektivave që janë përcaktuar në *Strategjinë e zhvillimit* dhe *Manualin e cilësisë të Krka-s*. Me menaxhimin e mashtrimit ndërliiden edhe aktivitetet e kontrollit individual.

Regjistri i rreziqeve i Krka-s e përfshin një prezantim gjithëpërfshirës të të gjitha rreziqeve të mundshme. *Ai plotësohet nga Plani i integritetit*. Krka e integron menaxhimin e rrezikut në të gjitha proceset e punës së saj. Ne jemi duke e përdorur një numër të madh procedurash standarde operative dhe udhëzimesh të tjera të brendshme që i përcaktojnë aktivitetet e kontrollit dhe përgjegjësitë për veprimtarinë afariste të pandërprerë dhe reduktimin e rreziqeve.

Përgjegjësitë lidhur me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit nga nivelet e menaxhimit të korporatës janë saktësuar në tekstin e mëposhtëm.

Bordi Drejtues i Krka, dd, Novo mesto e siguron dhe mundëson krijimin e një mjedisi të përshtatshëm të kontrollit për ruajtjen e vlerës së asetëve dhe namit të kompanisë. Bordi Drejtues e cakton një Zyrtar Kryesor për Pajtueshmëri, i cili është përgjegjës edhe për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e **Zyrtarit Kryesor për Pajtueshmëri** përfshijnë:

- vlerësimin e rrezikut nga mashtrimi;
- propozimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit;
- trajtimin e duhur të çdo mashtrimi të dyshuar të raportuar dhe mbrojtjen e informatorëve;
- informimin, edukimin dhe ngritjen e vetëdijes së punonjësve për përmbajtjen e këtyre Rregullave;
- mbajtjen e një regjistri të raporteve dhe dokumentacionit që ka të bëjë me hetimet e dyshimeve për mashtrim;
- paraqitjen e raporteve lidhur me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit tek Bordit Drejtues;
- punën me profesionistë të jashtëm dhe organet e zbatimit të ligjit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e **drejtorëve të divizioneve, departamenteve dhe shërbimeve të pavarura** përfshijnë:

- vlerësimin e rreziqeve nga mashtrimi në fushën përkatëse nën kompetencën e tyre;
- zbatimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm për menaxhimin e mashtrimit;

- ndjekjen e parimit të tolerancës zero ndaj çdo forme të mashtrimit;
- bashkëpunimin me Zyrtarin Kryesor për pajtueshmëri në kryerjen e aktiviteteve të duhura nëse mashtrimi i dyshuar i referohet njësisë organizative të tyre.

Detyrat dhe përgjegjësitë e **secilit punonjës** përfshijnë:

- veprimin me ndershmëri dhe integritet në përputhje me Kodin e Sjelljes dhe të gjitha rregulloret e tjera përkatëse të Krka-s;
- raportimin e çdo ngjarje apo transaksioni që mund të tregojë mashtrim të mundshëm;
- ruajtjen dhe mbrojtjen e çdo dëshmie të mashtrimit të mundshëm;
- ndjekjen e parimit të tolerancës zero ndaj çdo forme të mashtrimit.

V. Procedurat dhe aktivitetet e menaxhimit të mashtrimit

Procedurat dhe aktivitetet e menaxhimit të mashtrimit ndahen në tri kategori: parandalimi, zbulimi dhe hetimi i mashtrimit. Fokusi kryesor është në parandalimin e mashtrimit. Aktivitetet e zbulimit të mashtrimit janë gjithashtu të rëndësishme, por hetimi i mashtrimit në rast të dyshimeve për mashtrime të mëdha hyn në kuadër të juridiksionit të profesionistëve të kualifikuar dhe institucioneve përkatëse.

Aktivitetet e rregullta të menaxhimit të mashtrimit përfshijnë edhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme për uljen e rrezikut nga mashtrimi duke i miratuar dhe ndryshuar rregullat dhe udhëzimet e brendshme.

Krka e siguron menaxhimin e konfliktit të interesit me procedura dhe rregulla standarde operative që i reduktojnë rreziqet dhe i parandalojnë konfliktet e interesit që mund ta dëmtojnë reputacionin e Krka-s.

Krka siguron që të gjitha marrëdhëniet me fushën e mjekësisë të realizohen në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet në fuqi dhe që mundësitë për shfaqjen e sjelljeve të paligjshme të zvogëlohen. Bashkëpunëtorët e kryejnë punën e tyre në përputhje me rregulloret dhe trajnohen siç duhet për promovimin e produkteve.

Edukimi dhe trajnimi i punonjësve janë thelbësorë për menaxhimin e suksesshëm të mashtrimit. Programet e trajnimit të Krka-s, njoftimet e publikuara së brendshme dhe tabelat e njoftimeve sigurojnë nivel adekuat të informimit, në bazë të të cilit punonjësit janë në gjendje t'i zbulojnë mashtrimet e mundshme apo aktivitetet e veçanta që mund të përbëjnë mashtrim.

VI. Raportimi i mashtrimit të dyshuar

Çdo punonjës i Krka-s dhe çdo palë e tretë mund ta raportojë ndonjë mashtrim të dyshuar.

Nëse ndonjë punonjës i Krka-s zbulon ndonjë akt që tregon dyshime për mashtrim, ai duhet ta informojë eprorin e tij. Nëse natyra e mashtrimit të dyshuar ose rrethanat e tij nuk e lejojnë këtë, ai duhet ta informojë Shefin e Çështjeve Ligjore ose Zyrtarin Kryesor për Pajtueshmëri. Mashtrimi i dyshuar mund të raportohet edhe në mënyrë anonime. Adresa e emailit për raportimin e mashtrimit të dyshuar është compliance.officer@krka.biz.

Nëse informatori nuk dëshiron të mbetet anonim, ai mund t'ia raportojë mashtrimin e dyshuar me telefon:

- Zyrtarit Kryesor për Pajtueshmëri në
- Shefit të Çështjeve Ligjore në

Krka zotohet se do t'i trajtojë të dhënat e informatorit në mënyrë konfidenciale, profesionale dhe me kujdesin e duhur dhe do ta mbrojë informatorin siç duhet ndaj çdo mase hakmarrëse.

VII. Procedura për trajtimin e raporteve

Në bashkëpunim me Çështjet Ligjore, Zyrtari Kryesor për Pajtueshmëri mund ta formojë një ekip të veçantë për t'u marrë me raportet hyrëse. Përveç Zyrtarit Kryesor për Pajtueshmëri, ekipi mund të përbëhet edhe nga dy deri në katër punonjës nga njësi të ndryshme organizative që i posedojnë shkathtësitë e veçanta për hetimin e mashtrimit të dyshuar. Ekipi e trajton siç duhet çdo mashtrim të dyshuar të raportuar, i heton shkaqet e tij dhe sugjeron masa korrigjuese dhe parandaluese. Hetimet e mashtrimit i bëjnë

punonjësit që i kanë shkathtësitë e duhura dhe – nëse është e nevojshme – profesionistët e jashtëm dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit.

Informatori që e raporton mashtrimin e dyshuar në mirëbesim dhe pa qëllime të dëmshme mbrohet nga veprimet hakmarrëse; atij i ofrohet mbështetja e duhur dhe mund të informohet për rezultatin e raportit të tij. Të dhënat e informatorit duhet të trajtohen si konfidenciale. Çdo veprim hakmarrës trajtohet si shkelje veçanërisht e rëndë e *Kodit të Sjelljes të Krka-s*.

Zyrtari Kryesor për Pajtueshmëri duhet ta mbajë një regjistër të raporteve hyrëse, procedurave të zbatuara dhe aktiviteteve të zhvilluara në lidhje me raportet.

Bazuar në rezultatet e hetimit, Zyrtari Kryesor për Pajtueshmëri ia propozon njërin nga opsionet e mëposhtme njësisë organizative përkatëse dhe, nëse është e nevojshme, Bordit Drejtues:

- Raporti për mashtrimin e dyshuar është i pabazuar dhe nuk ka nevojë për hetim të mëtejshëm;
- Raporti për mashtrimin e dyshuar është i bazuar, kërkohen masa të brendshme, siç janë sanksionet dhe përmirësimi i procedurave të kontrollit;
- Raporti për mashtrimin e dyshuar është i bazuar dhe kërkohet që të kryhen hetime të mëtejshme nga punonjësit që i kanë shkathtësitë e duhura, profesionistët e jashtëm apo zyrtarët e zbatimit të ligjit.

Mashtrimet e dyshuara hetohen në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi.

VIII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Bordi Drejtues i kompanisë i miraton *Rregullat*. *Rregullat* publikohen në faqen e brendshme të Krka-s (Krkamet) dhe në faqen publike të Krka-s.

Më datën e hyrjes në fuqi të këtyre *Rregullave*, *Rregullat për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit* të 7 dhjetorit të vitit 2015 dhe *Politika për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit* më 7 dhjetor 2015 skadojnë.

Këto rregulla duhet të rishikohen një herë në dy vjet dhe të ndryshohen nëse është e nevojshme.